



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 747/26
Data. 21.07.26

Prishtinë, 10 korrik 2026

Kodi i ZRRE-së: V_3349_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenin 25, Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.24 dhe 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L – 085);
- Dispozitat e Nenit 14.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.) për shqyrtim dhe aprovim të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2026,

në seancën e mbajtur me datë 10 korrik 2026, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - Planit i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2026.

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (në tekstin e mëtejme: OSSH) kërkesën për aprovim të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2026.
- o Planit i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2026 është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili paraqet planin vjetor të zvogëlimit të humbjeve të OSSH në pajtim me cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara për Periudhën e Tretë Rregullative nga ZRRE, si dhe Planet Zhvillimore dhe Investive të OSSH-së.
- o Qëllimi kryesor i Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2026 është që të projektojë planin e veprimit për zvogëlimin e humbjeve përmes investimeve kapitale dhe optimizimit të operimeve, si dhe pritshmërinë e



zvogëlimit të humbjeve përgjatë vitit 2026.

- ZRRE, në përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka vendosur në konsultim publik dokumentin, Planin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2026, duke ju ofruar mundësinë të gjitha palëve të interesit të ofrojnë komentet e tyre brenda 15 ditëve nga data e publikimit.
- ZRRE, pas analizimit dhe vlerësimit të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2026 dhe pas përfshirjes së komenteve ka vlerësuar se i njëjti është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe i harmonizuar me caqet e vendosura nga ZRRE përmes Vendimit V_1636_2022 për Cakun e Reduktit të Humbjeve për Periudhën e Tretë Rregullative, të cilat pritet që në fund të vitit 2026 të arrijnë në 12.10%.
- Bordi i ZRRE-së, duke u bazuar në analizën e dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimin dhe shqyrtimit të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2026, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2026

Bordi i ZRRE-së,

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KEDS Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji